



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr. 2004 / 10**

**LIGJI PËR ENERGJINË ELEKTRIKE**

Kuvendi i Kosovës

Në bazë të kompetencave që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 Qershor 1999,

Duke patur parasysh Misionin e Përkohshëm të Administratës të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Rregullorja Nr. 1999/1 të 25 Korrikut 1999, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë;

Duke u mbështetur në autorizimet që u janë dhënë Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2001/9 të datës 15 Maj 2001, „ Mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme,“ veçanërisht Neni 5.1 (ç) dhe 9.1.26 (a);

Duke marrë parasysh kompetencat e rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në bazë të Nenit 8.1 (r) të Kornizës Kushtetuese,

Duke njohur nevojën për vendosjen e standardeve dhe kushteve për një sistem të integruar të prodhimit, bartjes, distribuimit, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike në mënyrë që të arrihet zhvillimi i një tregu konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike;

Vendosi të miratojë si vijon:

**LIGJI PËR ENERGJINË ELEKTRIKE**

**Kreu 1**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Ky ligj vendos kushtet për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, bartjes, distribuimit, furnizimit, tregtimit, eksportimit, importimit dhe tranzitit të energjisë elektrike; organizimin e sistemeve elektroenergjetike dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike.

## Neni 2

Qëllimet e këtij ligji janë:

- a). të arrijë zhvillimin e një tregu konkures dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike;
- b). të garantojë kushtet për furnizim të sigurtë, qëndrueshëm, efikas dhe të përhershëm me energji elektrike;
- c). kurdo që është teknikisht dhe ekonomikisht e arsyeshme, të sigurojë që të gjithë klientët e fundit të kenë shërbim universal, që është e drejta për t'u furnizuar me një sasi të caktuar të energjisë elektrike në Kosovë, me çmime të arsyeshme.

## Neni 3

3.1. Termet e përdorura në këtë ligj do të kenë domethënjen vijuese:

**“shërbimet vartëse”** do të thotë të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemeve të bartjes dhe distribuimit;

**“rrjetat ndihmëse”** do të thotë të gjitha rrjetat për kontrollimin, rregullimin, mbrojtjen, komunikimin dhe informimin, të nevojshme për funksionimin efektiv të rrjetave të bartjes dhe distribuimit;

**“çertifikata e prejardhjes”** nënkupton dokumentin e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që dëshmon shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë ose hedhurinave për prodhimin e energjisë elektrike apo bashk-prodhimin e ngrohjes dhe energjisë elektrike;

**“linjë e drejtpërdrejt”** do të thotë, ose një linjë të energjisë elektrike që e lidhë një lokacion të izoluar të prodhimit me një klient të izoluar; ose një linjë e energjisë elektrike që e lidhë një prodhues të energjisë elektrike me një ndërmarrje për furnizim të drejtpërdrejt për godinat e tyre, ndërmarrjet vartëse ose konsumatorët e privilegjuar;

**“dispeçingu”** nënkupton veprimtaritë e nevojshme për qarkullimin, bartjen, importimin ose eksportimin e energjisë elektrike në sistemin e energjisë elektrike, për të siguruar adaptimin e prodhimit të energjisë elektrike me konsumimin e saj;

**“distribuimi”** do të thotë transportimi i energjisë elektrike me tension të mesëm ose të vogël me qëllim të dërgimit gjer tek klienti, por pa përfshirë furnizimin;

**“Operatori i sistemit të distribuimit”** do të thotë një person fizik ose juridik që është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e një sistemi të distribuimit në një lëmi të caktuar. Gjithashtu, kur është e mundëshme, në ndërlidhje me sistemet e tjera, të sigurojë që sistemi t'i përmbushë nevojat për distribuimin e energjisë elektrike;

**“rrjeti i distribuimit”** do të thotë kombinimi i linjave të energjisë elektrike dhe njësive të energjisë elektrike me tension të mesëm dhe të vogël që shërbejnë për distribuimin e energjisë elektrike;

**“ndërmarrje e energjisë elektrike”** do të thotë një organizatë afariste që kryen një apo më shumë aktivitete të prodhimit, bartjes, distribuimit, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike në bazë të licensës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji ose pa licensë, nëse licensa në fjalë nuk kërkohet.

**“lokacion i energjisë elektrike”** do të thotë: një central për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe rrjetet e instalimet vartëse të tij; rrjetet e bartjes dhe stacionet e tyre të transformimit; sistemet e distribuimit; që janë të lidhura drejtpërdrejt me pajisjet e klientit; qarqet ndërlidhëse dhe linjat direkte.

**“konsumator i privilegjuar”** është konsumatori që është i lirë të blerë energji elektrike nga furnizuesi i zgjidhjes të tij/saj.

**“eksportimi i energjisë elektrike”** do të thotë bartje e energjisë elektrike nga Kosova në një vend tjetër nga Kosova, nën kuptimin se në të njëjtën kohë energjia elektrike do të pranohet në një vend të tretë;

**“konsumatori i fundit”** është konsumatori që blenë energjine elektrike për përdorimin vetijak.

**“prodhim”** është prodhimi i energjisë elektrike.

**“ndër-lidhësit”** do të thotë pajisjet për lidhjen e sistemeve elektrike;

**“sistem i ndër-lidhur”** do të thotë një numër i sistemeve të bartjes dhe distribuimit të lidhura së bashku përmes një ose më shumë ndërlidhësve;

**“importimi i energjisë elektrike”** domethënë pranimi i energjisë elektrike nga Kosova prej një shteti tjetër.

**“KEK”** do të thotë Korporata Elektroenergjetike e Kosovës me vendndodhje në Kosovë dhe me qendër në Prishtinë.

**“pajisjet matëse”** janë instrumentet e regjistruara në regjistrin për certifikimin e pajisjeve matëse në Kosovë dhe që përdoren gjatë procesit të furnizimit me energji elektrike;

**“MW”** do të thotë megavat që nënkupton njësinë matëse të fuqisë së kapaciteteve të energjisë elektrike.

**“treg i organizuar”** do të thotë një varg transaksionesh dhe marrëdhënesh afarsite për tregtimin e energjisë elektrike, ku vendi, koha dhe mënyra e përmbylljes së transaksioneve dhe vendosjes së marrëdhënjeve afariste në fjalë njihet publikisht dhe është shpallur më parë në rregullat e tregtimit.

**“prodhues”** do të thotë personi fizik ose juridik që prodhon energji elektrike;

**“furnizimi publik”** do të thotë shitja e energjisë elektrike nga furnizuesi publik për klientët tarifor;

**“reciprocitet”** domethënë se kushtet për qasje në rrjetë në një shtet të tretë janë reciproke me ato të Kosovës dhe se një konsumator i privilegjuar konsiderohet si i privilegjuar në të dyja sistemet pjesëmarëse;

**“furnizimi”** do të thotë shitjen, duke përfshirë edhe ri-shitjen e energjisë elektrike konsumatorëve;

**“shfrytëzuesit e sistemit”** do të thotë personat fizik dhe juridik që e furnizojnë ose furnizohen nga një sistem i bartjes ose distribuimit.

**“tregtimi”** do të thotë transaksionet e shit-blerjes të kryera në bazë të licencës nga ana e tregtuesit.

**“tranzit”** është transportimi i i energjisë matanë një kufiri nacional pa prodhim apo konsumim në atë shtet.

“**bartje**” do të thotë bartja e energjisë elektrike, me tension shumë të lartë dhe me tension të lartë tek sistemi i ndërlidhur me qëllim të dërgimit gjer tek klienti ose distributori, por pa përfshirë furnizimin;

“ **rrjeti i bartjes** “ është kombinimi i linjave të energjisë elektrike dhe njësive të energjisë elektrike me tension të lartë që shërben për bartjen e energjisë elektrike.

“**operator i sistemit të bartjes**” do të thotë person fizik ose juridik përgjegjës për operimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të bartjes dhe, ku është e nevojshme, zhvillimi e rrjetit të bartjes në një sektor të caktuar, aty ku aplikohet, të lidhë interkonektorët me rrjete të tjera, dhe sigurimin e rrjetit për të përballuar kërkesat për bartjen e energjisë elektrike.

“**ndërrmarjet e integruara vertikalisht**” janë ndërrmarjet për energji elektrike që kryejnë të paktën një funksion për bartje apo distribuim dhe të paktën një funksion për prodhimin apo furnizimin me energji elektrike.

3.2. Termat tjerë në këtë ligj, do të kenë domethënie siç është cekur në Ligjin për Energjinë, apo në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

## **Kreu 2 SISTEMI I ENERJISË ELEKTRIKE**

### Neni 4

4.1. Të gjitha lokacionet e energjisë elektrike në Kosovë duhet të jenë të lidhura dhe të veprojnë nën një sistem të vetëm të energjisë elektrike me synimin e përbashkët për prodhimin, bartjen, distribuimin dhe furnizimin e vazhdueshëm të energjisë elektrike.

4.2. Sistemi i energjisë elektrike në Kosovë vepron në mënyrë paralele, dhe mund të lidhet me sistemin e energjisë elektrike të Shqipërisë dhe vendeve të tjera në tregun rajonal të energjisë elektrike ku sistemi i energjisë elektrike është në përputhshmëri me standardet teknike dhe të sigurisë të njohura nga Bashkimi Europian.

## **Kreu 3 PRODHIMI I ENERJISË ELEKTRIKE**

### Neni 5

Prodhimi i energjisë elektrike kryhet nga ndërmarrjet e energjisë elektrike që posedojnë licenca për prodhim ose nga persona fizik apo juridik që janë përjashtuar nga detyrimi për bartjen e licencës sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

### Neni 6

Prodhuesi i energjisë elektrike ka të drejtë:

- a). të shfrytëzoj burimet e energjisë që i konsideron më të përshtatshme për procesin e prodhimit në centralin elektrik të tij, me kusht që shfrytëzimi i burimeve në fjalë të jetë në përputhshmëri me rezultatet, karakteristikat teknike dhe kushtet mjedisore të përcaktuara në licencë dhe në ligjet, rregulloret kodet apo rregullat relevante;

- b). të lidhin centralet e tyre të prodhimit me rrjetat e bartjes dhe distribuimit sipas kushteve të vendosura në këtë ligj dhe kodet e rregullat e tjera përkatëse;
- c). të lidhin kontrata për shitjen e energjisë elektrike sipas kushteve të vendosura në këtë ligj, dhe rregullave të nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji;
- d). bartjen e energjisë së tyre elektrike përmes rrjetave të bartjes dhe distribuimit;
- e). pranojnë kompensimin që u takon sipas kontratave.

#### Neni 7

Prodhuesi i energjisë elektrike ka detyrimet në vijim:

- a). që të plotësoj të gjitha kushtet e cekura në liqencë për ushtrimin e aktiviteteve të tij të prodhimit nëse liçenca është e nevojshme;
- b). që të veprojë sipas rregullave përkatëse teknike dhe rregullave të vendosura nga operatorët e sistemit përfshirë edhe Kodin e Rrjetit;
- c). që të veproj sipas rregulloreve për mbrojtjen e mjedisit dhe të kontrollojë ndikimin që aktivitetet e tij kanë në mjedis;
- d). që të pajiset më pajisje adekuate për matjen e energjisë elektrike që hyn në rrjetë;
- e). të përmbush të gjitha detyrimet e tjera që mund të dalin nga ky ligji, ligjet tjera dhe rregulloret relevante.

#### Neni 8

Prodhuesi me një stabiliment për energji me kapacitet më të madh se 5 MW që ekziston dhe është në funksion në datën e shpalljes të këtij ligji do të jetë i detyruar të shesë energji elektrike, që prodhon nga stabilimenti i tij për energji, furnizuesit publik me një çmim të rregulluar në rast se furnizuesit publik i nevojitet ajo energji elektrike.

#### Neni 9

Me përjashtim të kushtëzimeve në nenin 8, prodhuesi mund t'ju ofrojë energjinë elektrike të prodhuar nga ai, apo kapacitetin e elektranave të tij, me një çmim të negociuar lirë:

- a). konsumatorëve vendorë të privilegjuar përmes kontraktimit dypalësh duke shfrytëzuar shërbimet e detyruara të operatorit të sistemit të bartjes dhe të distribuimit;
- b). tregtarëve vendorë, përmes kontraktimit dypalësh duke shfrytëzuar shërbimet e detyruara të operatorit të sistemit të bartjes;
- c). klientëve ose tregtarëve të privilegjuar të jashtëm;
- d). në tregun lokal ose rajonal të këmbimit të energjisë elektrike;
- e). furnizuesit publik, në rast se kërkesa e klienteve për energji elektrike rritet përtej kapacitetit të përgjithshëm të kontraktuar të të gjithë prodhuesve në pajtim me nenin 8.

## Neni 10

10.1. Ndërmarrjet e energjisë që prodhojnë energji elektrike duke shfrytëzuar burimet e ripërtitshme të energjisë ose hedhurinat dhe bashkë-prodhimin, që prodhojnë energji elektrike dhe ngrohje në një objekt të veçantë energjetik, kanë të drejtë të marrin çertifikatën e prejardhjes nga Zyra e Rregullative për Energji.

10.2. Në çertifikatën e prejardhjes, Zyra e Rregullatorit për Energjisë:

- a). vërteton kapacitetin e centralit elektrik që shfrytëzon burimet e ripërtitshme të energjisë dhe hedhurinat në mënyrë shembullore si burime për prodhim;
- b). saktëson afatet për paraqitjen e informacioneve dhe raporteve te Zyra e Rregullatorit për Energji;

10.3. Furnizuesit publik u japin përparësi në blerje energjisë elektrike për të cilën është marrë çertifikata e origjinës, me kusht që kostua e energjisë të tillë elektrike nuk shpie çmimin e energjisë elektrike në Kosovë një nivel jo stabil.

10.4. Nga furnizuesi publik kërkohet që ta blejë, me çmim të rregulluar, gjithë sasinë e energjisë elektrike të prodhuar për të cilën ekziston çertifikata e origjinës, për plotësimin e nevojave me energji elektrike në Kosovë me përjashtim të sasisë për të cilën prodhuesi i ka lidhur kontratë sipas dispozitave të këtij ligji. Zyra e Rregullatorit për Energji, mund t'ia kompenzojë shpenzimet furnizuesit publik, përmes një tarife të veçantë për shërbimet e operatorit të sistemit të bartjes.

## Neni 11

11.1. Prodhuesit e energjisë elektrike me obligime të shërbimeve publike janë të obliguar të mbajnë rezerva të lëndëve djegëse në sasi të mjaftueshme për të përballuar prodhimin e vazhdueshëm dhe të besueshëm të energjisë elektrike ose kapacitet prodhues të posaçëm rezervë të energjisë elektrike që t'iu sigurojë konsumatorëve furnizimin e sigurtë.

11.2. Lloji dhe niveli i depove rezervë të lëndëve djegëse ose i kapacitetit prodhues të posaçëm rezervë përcaktohet nga Ministria Përgjegjëse për Energji.

## **Kreu 4 BARTJA E ENERGISË ELEKTRIKE**

## Neni 12

12.1. Përbrenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, pas shpalljes së këtij ligji, Qeveria e Kosovës përzgjedhë në bazë të konkurrencës personin juridik si kandidat për postin e Operatorit të Sistemit të Bartjes. Kandidati duhet të aplikojë për liçencë tek Zyra e Rregullatorit për Energji brenda 90 ditëve nga data e përzgjedhjes nga Qeveria.

12.2. Kur Operatori i rrjetit të bartjes është pjesë e ndërmarrjes së integruar vertikalisht, ai duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e tjera që nuk kanë të bëjnë me bartjen në kuptim të formës së tij juridike, organizimit dhe vendimmarrjes.

12.3. Me qëllim të sigurimit të pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Bartjes, vlejné kriteret vijuese:

- a). ata individë që janë përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Bartjes nuk mund të marrin pjesë në strukturat e kompanisë të ndonjë ndërmarrjeje energjetike përgjegjëse, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për operimin e përditshëm të prodhimit, distribuimit dhe furnizimit me energji elektrike;
- b). duhet të merren masa të përshatshme për t'u siguruar që interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Bartjes janë marrë parasysh në atë mënyrë që sigurojnë se ata janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur;
- c). Operatori i rrjetit të bartjes ka të drejta efektive të vendimmarrjes, pavarësisht nga ndërmarrja energjetike e integruar vertikalisht, në lidhje me asetet e domosdoshme për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetës. Sidoqoftë, kompania kryesore mund të miratojë një plan vjetor financiar të propozuar nga operatori i rrjetit bartës ku do të përfshihet niveli më i lartë i borxhit.
- d). Operatori i rrjetit të bartjes harton dhe Zyra e Rregullatorit aprovon programin e mbarëvajtjes që parashikon masat që sigurojnë përjashtimin e sjelljes diskriminuese dhe siguron mbikëqyrjen adekuate të tij. Programi duhet të përcaktojë obligimet e veçanta që të punësuarit duhet t'i përmbushin. Një plan vjetor publik, që do të përcaktojë masat e ndërmara, do të parashtrahet nga personi apo organi përgjegjës për monitorimin e mbarëvajtjes të programit për Zyrën e Rregullatorit për Energji.

### Neni 13

13.1. Operatori i rrjetit të bartjes është përgjegjës:

- a). për veprimin, mirëmbajtjen, dhe në rastet ku paraqitet nevoja, zhvillimin e rrjetit bartës dhe ndërlidhësve të tij me rrjete të tjera, me qëllim që të garantohet sigurimi i furnizimit;
- b). për menaxhimin e rrjedhjes së energjisë në sistemin e bartjes, duke marrë parasysh shkëmbimet me rrjetat tjera të ndërlidhura, dhe ruajtjen e balancit;
- c). për sigurimin e vënies në disponim të të gjitha shërbimeve ndihmëse;
- d). për dhënien e informacioneve të mjaftueshme operatorit të çdo sistemi tjetër me të cilin është i ndërlidhur sistemi i tij për sigurimin e një operacioni të sigurtë dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërfunksionalitetin e sistemeve të ndërlidhura;
- e). për sigurimin e jo-diskriminimit dhe ndërfunksionimit të sistemit të ndërlidhur;
- f). ofrimi i informacioneve përdoruesëve të rrjeteve që u nevojiten për qasje efikase në rrjetë;
- g). dispecingu i prodhimit dhe vendosjen për përdorim të inter-konektorëve;
- h). zhvillimi i udhëzimeve parashikuese në pajtim me procedurat e përcaktuara në Ligjin për Energjinë;
- i). organizimi i studimeve preliminare për mundësitë e ndërtimeve të reja të kapaciteteve bartëse, stabilimeve, dhe pajisjeve të ndihmuara nga studime teknike, ekonomike dhe financiare;

- j). hartimi dhe publikimi i planeve afatshkurtra dhe afatgjata për zgjerimin dhe modernizimin e rrjeteve bartëse;
- k). cdo dy vjet, përgatitja e listës të kapaciteteve të reja bartëse rajonale dhe linjat e energjisë interkonekcioneve të nevojshme për të pëmbushur kërkesat në Kosovë;
- l). kryerja e aktiviteteve të tjera që nevojiten për të avancuar detyrat e tij sic janë paraparë me ligj.

13.2. Jo më vonë se 90 ditë pas datës së lëshimit të liçencës nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Operatori i rrjetit të bartjes duhet t'ia dërgojë Zyrës të Rregullatorit për Energji për miratim Kodin e Rrjetës i cili mes tjerash:

- a). parashtron rregullat teknike që përcaktojnë dizajnin minimal teknik dhe kriteret e operimit për lidhjen në rrjetë dhe ndërlidhjen dhe operimin e rrjetave tjera;
- b). identifikon kriteret ekonomike për shpërndarjen dhe përdorimin duke marrë parasysh furnizimin e qëndrueshëm dhe të nevojshëm;
- c). përcakton procedurat e aplikueshme për operimin e rrjetës në situata të jashtëzakonshme.

13.3. Rregullat e Kodit të Rrjetës duhet të publikohen; duhet të sigurojnë ndërfunksionimin e rrjetave; duhet të jenë objektive dhe jo-diskriminuese; duhet të zbatohen në mënyrë objektive dhe jo-diskriminuese.

#### Neni 14

Gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike të prodhuar, Operatori i rrjetit të bartjes duhet t'iu japë përparësi pajisjeve prodhuese që shfrytëzojnë burimet e ripërtëritshme të energjisë ose hedhurinat ose që prodhojnë në formë të kombinuar energji elektrike dhe ngrohje.

#### Neni 15

15.1. Operatori i rrjetit të bartjes siguron energji për nevojat e kryerjes së funksioneve të tij në pajtim me procedurat transparente, jo-diskriminuese dhe, kur është e mundur, të bazuara në treg.

15.2. Rregullat e miratuara nga Operatori i Sistemit të Bartjes, për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, duhet të jenë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese, duke përfshirë rregullat për ngarkimin e shfrytëzuesve të sistemit të rrjetave të tyre për balancimin e sistemit.

15.3. Kushtet, duke përfshirë rregullat dhe tarifrat, përfshirë siguriminn e shërbimeve nga Operatori i rrjetit të bartjes përcaktohen në mënyrë jo-diskriminuese dhe me kosto efektive. Rregullat dhe tarifrat u nënshtrohen miratimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe publikohen.



## Neni 16

16.1. Operatori i rrjetit të bartjes nuk duhet të zbulojë informacionin konfidencial të marrë gjatë kryerjes së biznesit të tij dhe duhet të parandalojë informacionet mbi aktivitetet e tij që, nga zbulimi i tyre në mënyrë diskriminuese, mund të jenë të leverdishme në pikëpamje komerciale.

16.2. Pa rënë ndesh me paragrafin (1) të këtij neni, Zyra e Rregullatorit për Energji mund t'i kërkojë Operatorit të Sistemit të Bartjes informacionin konfidencial i cili është i domosdoshëm për t'i kryer funksionet, autorizimet dhe detyrat e saj.

## **Kreu 5 DISTRIBUIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE**

### Neni 17

17.1 Përbrenda 60 ditëve, pas shpalljes së këtij Ligji Qeveria e Kosovës emëron një apo më shumë persona juridik si kandidat për postin e Operatorit të Sistemit të Distribuimit. Kandidati duhet të aplikojë për licencë tek Zyra e Rregullatorit për Energji brenda 90 ditëve nga data e përzgjedhjes nga Qeveria.

17.2. Kur Operatori i Sistemit të Distribuimit është pjesë e ndërmarrjes së integruar vertikalisht, ai duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e tjera që nuk kanë të bëjnë me bartjen në kuptim të formës së tij juridike, organizimit dhe vendimmarrjes.

17.3. Me qëllim të sigurimit të pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Distribuimit, vlejné kriteret vijuese:

- a). ata individë që janë përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Distribuimi nuk mund të marrin pjesë në strukturat e kompanisë të ndonjë ndërmarrjeje energjetike përgjegjëse, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për operimin e përditshëm të prodhimit, distribuimit dhe furnizimit me energji elektrike;
- b). duhet të merren masa të përshatshme për t'u siguruar që interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Distribuimit janë marrë parasysh në atë mënyrë që sigurojnë se ata janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur;
- c). Operatori i Sistemit të Distribuimit ka të drejta efektive të vendimmarrjes, pavarësisht nga ndërmarrja energjetike e integruar vertikalisht, në lidhje me asetet e domosdoshme për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetës. Sidoqoftë, kompania kryesore mund të miratojë planin vjetor financiar të propozuar nga operatori i rrjetit distributiv dhe përfshijë nivelin maksimum të borxhit.
- d). Operatori i Sistemit të Distribuimit harton programin e mbarëvajtjes, i cili përcakton masat e ndërmara për të siguruar përjashtimin e sjelljes diskriminuese dhe siguron mbikëqyrjen adekuate të tij. Programi duhet të parashtrij obligimet e veçanta që të punësuarit duhet t'i përmbushin. Një plan vjetor publik, që përcakton masat e ndërmara, do t'i parashtrijet personit apo organit kompetent për monitorimin e mbarëvajtjes të programit për Zyrën e Rregullatorit për Energji.

## Neni 18

18.1. Operatorët e sistemeve të distribuimit janë përgjegjës:

- a). për mirëmbajtjen e një sistemi të distribuimit të energjisë elektrike të sigurtë, të besueshëm dhe efikas në zonën e tyre me kujdesin e duhur për ambientin e njeriut;
- b). për sigurimin e jo-diskriminimit ndërmjet shfrytëzuesve të rrjetit ose kategorisë së shfrytëzuesve të rrjetit, posaçërisht në dobi të një dege (filiali) a aksioneri;
- c). për furnizimin e shfrytëzuesve të sistemit me informacionet që iu nevojitet atyre për qasje efikase në sistem;
- d). për planifikimin e zhvillimit të rrjetës të distribuimit, duke marrë parasysh masat efikase të energjisë ose prodhimit e shpërndarë që mund të plotësojnë nevojën për modernizimin apo zëvendësimin e kapaciteteve të energjisë elektrike;
- e). hartimin dhe publikimin e planeve afatgjate dhe afatshkurta për zhvillimin e rrjeteve distributive dhe koordinimi i planeve të tilla me komunat;
- f). studimin e zhvillimeve ekonomike dhe prospekti i ndryshimeve në kërkesa në territorin e vet;
- g). ndihmojë komunave në përgatitjen e planeve, programeve dhe strategjive zhvillimore;
- h). hapja e planeve zhvillimore afatgjate dhe afatshkurta për operatorin e rrjetit bartës.

18.2. Një Operator i rrjetit të distribuimit do të blerë energji elektrike për ta përdorur gjatë kryerjes të detyrave sipas procedurave transparente, jo-diskriminuese dhe të bazuara në treg.

## Neni 19

19.1. Operatori i rrjetës së distribuimit nuk lejohet të zbulojë informacionin konfidencial të marrë gjatë kryerjes së biznesit të tij dhe parandalojë informacionet mbi aktivitetet e tij që mund të jenë të levërdishme në pikëpamje komerciale nga zbulimi i tyre në mënyrë diskriminuese.

19.2. Pa rënë ndesh me paragrafin (1) të këtij neni, Zyra e Rregullatorit për Energji mund t'i kërkojë Operatorit të sistemit të distribuimit informacionin konfidencial i cili është i domosdoshëm për t'i kryer funksionet, autorizimet dhe detyrat e saj.

## **Kreu 6 FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE**

### Neni 20

20.1. Furnizimi me energji elektrike është aktivitet i shitjes ose rishitjes së energjisë elektrike te konsumatori.

20.2. Furnizimi me energji elektrike duhet të kryhet nga furnizuesi publik, tregtuesit ose prodhuesit.

## Neni 21

21.1. Furnizuesi publik do të jetë një ndërrmarje me licencë për furnizimin publik të energjisë elektrike.

21.2. Në bazë të licencës, furnizuesit me energji elektrike kanë të drejtat vijuese:

- a). të shesë, ekskluzivisht, energji elektrike konsumatorëve tariforë me çmime dhe tarifa të rregulluara, në pajtim me kushtet edhe konditat e licencës;
- b). blerë kapacitet dhe energji nga prodhuesit me kapacitet të instaluar prej më shumë se 5 MW që ekzistojnë nga data e shpalljes të këtij ligji, me çmime të rregulluara;
- c). blerë kapacitet dhe energji nga prodhues të tjerë me çmime që nuk janë të rregulluara;
- d). importojë kapacitet dhe energji në rast se kërkesat e konsumatorëve rriten mbi kapacitetin e kontraktuar;
- e). eksportojë kapacitet dhe energji në rastet kur kërkesat e konsumatorëve janë më të vogla se kapaciteti i kontraktuar;
- f). faturojë dhe mbledhë llogaritë nga konsumatorët e vet;
- g). procesojë ankesat e konsumatorëve.

21.3. Furnizuesi publik do të hyjë në Kontratën për Blerjen e Energjisë (KBE) me prodhuesit e energjisë elektrike. Një KBE do të përmbajë dispozitat vijuese:

- a). zgjatja e furnizimit;
- b). kushtet teknologjike dhe kualiteti i furnizimeve;
- c). orari i furnizimeve dhe marrja;
- d). përgjegjësia e furnizimit dhe marrjes;
- e). sanksionet për shkeljen e cilësdo dispozitë të kontratës;
- f). pagesën apo garancën e pagesës për furnizimet.

21.4. Kontratat vjetore do të përcaktojnë në detale më të thella komponentet obligative të KBE-së dhe do të përcaktojnë çmimet dhe elemente të tjera për faturimin e energjisë elektrike.

21.5. KBE-të do të lidhen për një vit ose maksimum për 5 vite me mundësi ripërtrimi.

21.6. Dispozitat e cilësdo KBE-je sipas këtij neni, do të jenë objekt miratimi dhe monitorimi nga ana e Zyrës të Rregullatorit për Energji.

21.7. Në cdo kontratë të hyrë me KEK-un para datës efektive të këtij ligji do të negociohet jo më vonë se 2 vjet nga data e shpalljes të këtij ligji.

## Neni 22

22.1. Furnizimi me kohë do të bëhet një aktivitet konkurses dhe cdo kompani e kualifikuar, qoftë ajo vendore apo e huaj, mund të aplikojë për të marrë licencë për furnizim me qëllim që të shërbejë konsumatorëve të privilegjuar në pajtim me kriteret e themeluara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

22.2. Ministria përgjegjëse për energji do të përcaktojë kushtet për determinimin e konsumatorëve të privilegjuar në një instrukcion për zbatim që duhet miratuar jo më vonë se 31 janari për çdo vit. Kriteret do të përfshijnë zgjatjen e konsumimit të energjisë elektrike dhe proporcionet e kostos të energjisë në krahasim me çmimet e produkteve dhe shërbimeve të tyre.

22.3. Një konsumator mund të fitojë statusin e konsumatorit të privilegjuar në përgjigje të një thirrje publike që Zyra e Rregullatorit për Energji duhet ta publikojë çdo vit.

22.4. Konsumatorët e privilegjuar do të kenë mundësinë të furnizohen nga një furnizues publik sipas procedurave të themeluara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

22.5. Konsumatorët e privilegjuar do ta njoftojnë me kohë operatorin e bartjes, mbi kontratat që do të nënshkruajnë për furnizimin me energji elektrike, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Kodin e Tregut lëshuar nga operatori i tregut dhe miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

## Neni 23

23.1. Një tregtues i energjisë elektrike do të jetë personi që posedon licencë për tregtimin e energjisë elektrike.

23.2. Kushtet dhe afatet për licencën e tregtimit do të vendosen nga Zyra e Rregullatorit për Energji që do kërkojnë që tregtari të jetë me reputacion të qëndrueshëm dhe ka kontrata blerjeje, që mbështesin tregtinë e tij.

23.3. Ne bazë të licencës, tregtari ka të drejtë të:

- a). shesë kapacitet dhe energji konsumatorëve të privilegjuar me çmime të parregulluara;
- b). blerë kapacitet dhe energji nga prodhues me çmime të pa rregulluara;
- c). blerë dhe shesë kapacitet dhe energji nga tregtarë të tjerë me çmime të pa rregulluara;
- d). blerë kapacitet dhe energji nga furnizues publik me çmime të rregulluara nëse kërkesa e konsumatorit është ulur nën kapacitetin e kontraktuar;
- e). importi dhe eksporti i kapacitetit dhe energjisë;
- f). faturojë dhe mbledhë llogaritë nga konsumatorët e vet;
- g). procesojë ankesat e konsumatorëve.

23.4. Një tregtar i energjisë elektrike do të paraqesë garancën financiare për të mbuluar transaksionet që i nënshkruan. Kërkesat për formën, llojin dhe shumën e garancës do të përcaktohen në Kodin e Tregut.

## Neni 24

24.1. Të gjithë prodhuesit e energjise elektrike të themeluara në Kosovë do të kenë mundësinë të ofrojnë furnizim stabilimenteve të tyre, njërive të tyre, dhe konsumatorëve të privilegjuar, nëpërmjet linjave direkte.

24.2. Të gjithë konsumatorët e privilegjuar në Kosovë do të kenë të drejtën të furnizohen nga një linjë direkte nga prodhues dhe ndërrmarje të energjisë për furnizim, aty ku është e mundur nga aspekti teknik dhe ekonomik.

24.3. Lejet për ndërtimin e linjave direkte do të jepen nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të kriterëve teknike të publikuara paraprakisht në Kodin e Tregut, që kanë të bëjnë me sigurinë, efikasitetin dhe integritetin e rrjeteve për bartje dhe distribuim.

## **Kreu 7** **QASJA E PALËS SË TRETË**

## Neni 25

25.1. Operatori i rrjetit të bartjes dhe operatori(ët) i sistemit të distribuimit duhet t'i lejojë prodhuesit, furnizuesit, dhe klientët e privilegjuar të kenë qasje në rrjetën e bartjes dhe të distribuimit në pajtim me Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe rregullave për operatorin e rrjetës.

25.2. Çmimi për shfrytëzimin e rrjetës propozohet nga operatorët relevantë të rrjetës një herë në vit në mënyrë që të nxitet efikasiteti dhe merret parasysh çmimi mesatar i 12 muajve pararendës. Tarifat miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe publikohen nga operatori i sistemit përkatës.

## Neni 26

26.1. Operatori i rrjetit të bartjes dhe operatori i sistemit të distribuimit mund të refuzojnë qasjen në rrjetën e bartjes dhe të distribuimit vetëm nëse kapacitetet ekzistuese nuk janë të mjaftueshme, dhe mungesa e kapaciteteve arsyetohet në bazë të sigurisë së furnizimit, rregullshmërisë ose kualitetit të furnizimit, duke marrë parasysh të gjitha rregullat në fuqi.

26.2. Arsyet për refuzim sipas paragrafit (1) të këtij neni paraqiten në raportin me shkrim me faktet mbështetëse, dhe u ipen palëve të treta të cilat kërkojnë të lidhin kontratë për qasje në rrjetë.

26.3. Çdo person të cilit i refuzohet qasja në rrjetë ose i cili kundërshton kushtet e parapara për qasje në rrjetë mund parashtrijë ankesë në Zyrën e Rregullatorit për Energji e cila merr vendim në përputhje me procedurat e parapara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

## **Kreu 8** **ORGANIZIMI I TREGUT**

### Neni 27

27.1. Brenda 60 ditëve pas shpalljes së këtij ligji, Qeveria e Kosovës, në baza konkurruese, do të përzgjedhë një person juridik, si kandidat për t'u bërë operator i tregut. Kandidati do të aplikojë për liçencë tek Zyra e Rregullatorit për Energji, brenda 90 ditësh, nga data e emërimit të tij nga Qeveria.

27.2. Kur operatori i tregut është pjesë e një ndërrmarjeje të integruar vertikalisht, do të jetë e pavarur nga aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me bartjen në formën e saj juridike, pronësore, organizative dhe vendim-marrëse, dhe nuk do të marrë pjesë në prodhim apo tregtim. Mund të jetë ndërrmarja e njëjtë si operatori i rrjetit.

27.3. Operatori i tregut do të jetë përgjegjës për menaxhimin ekonomik të rrjetit elektro-energjetik, dhe do të ndërrmarë menaxhimin shit-blerës të energjisë elektrike, në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj. Përgjegjësitë do të përfshijnë:

- a). evidentimin dhe ruajtjen e dosjeve të të gjitha marrëdhënieve kontraktuale, që përmbajnë detyrime të anasjellta në mes të furnizuesve dhe konsumatorëve tarifor;
- b). pranimin e ofertave (tenderuese) për furnizim me energji elektrike;
- c). aplikimin e procedurave të tenderit;
- d). njoftimin e pjesëmarrësve në treg dhe operatorit të sistemit bartës mbi procesin e marrëveshjes, planifikimi i qasjes në rrjetë, duke u bazuar në marrëveshje dhe çmimi i energjisë së mbetur;
- e). pranimin e informatave nga operatori i sistemit bartës, që kanë të bëjnë me rregullimin e ndryshimeve të nevojshme, bazuar në kapacitetet teknike dhe çdo situatë të jashtëzakonshme në rrjetin e bartjes dhe të distribuimit;
- f). vendosjen e çmimit të fundit për energji, për çdo periudhë kohore të specifikuar dhe njoftimi i të gjitha palëve pjesëmarrëse në treg;
- g). themelimin e rrjetit -kontabël për tregtimin, gjerë të çmimi i fundit i arrirë, si dhe dhënia e informatave mbi operimin e gjeneratorëve dhe kapacitetit prodhues, për çdo periudhë kohore; dhe
- h). njoftimet publike për trendet e reja në treg për një interval kohor.

27.4. Operatori i tregut do të kryejë detyrat e veta, në bazë të parimeve transparente, objektive dhe të pavarura.

27.5. Brenda 120 ditëve, nga data që, Zyra e Rregullatorit për Energji nxjerr liçencën për operatorin e tregut, operatori i tregut do t'i parashtrijë Zyrës së Rregullatorit për Energji, miratimin e rregullave të tregut, që përcaktojnë rregullat dhe rregulloret për participimin në tregun e energjisë elektrike.

## Neni 28

28.1. Me qëllim që të mbahet bilanci në tregun e organizuar, prodhuesit, tregtarët, furnizuesi publik dhe konsumatorët e privilegjuar mund të hynë në kontrata për shitjen e energjisë elektrike me :

- a). me persona vendorë në shtetet anëtare të BE-së;
- b). persona të regjistruar në një shtet me të cilat Kosova ka një marrëveshje për aplikim të përbashkët të legjislacionit për energji të BE-së.

28.2. Paragrafi 28.1 do të aplikohet kur:

- a). prodhuesve, tregtarëve, furnizuesit publik dhe konsumatorëve të privilegjuar u është njohur e drejta për të tregtuar në mënyrë të lirë me energji elektrike në pajtim me ligjin e një shteti tjetër.
- b). Në bazë të dispozitave reciproke, ligji i një shteti tjetër mundëson tregtimin e lirë të energjisë elektrike për konsumatorët e privilegjuar të atij shteti.

## **Kreu 9 SHËRBIMI I FURNIZIMIT**

### Neni 29

29.1. Çdo konsumator i fundit ka të drejtë të përgjithshme për t'u furnizuar me energji elektrike kur është teknikisht dhe ekonomikisht e mundshme.

29.2. Konsumatorët përfundimtar kanë të drejtë të kontraktjnë me një furnizues të energjisë elektrike në bazë të rregullave të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

29.3. Furnizimi i ekonomive shtëpiake dhe ndërmarrjeve të vogla me energji elektrike bëhet në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

### Neni 30

30.1. Operatori i rrjetit të distribuimit apo bartjes duhet ta lidhë çdo konsumator apo prodhues që:

- a). ka pajisjen shpërndarëse elektrike të vendosur në pronën e vet e cila i plotëson nevojat teknike dhe operacionale mbi kriteret e sigurisë së kërkuar;
- b). i plotëson kushtet për t'u lidhur në rrjetin e distribuimit apo bartjes;
- c). e ka nënshkruar një marrëveshje me shkrim me ndërmarrjen e distribuimit apo të bartjes për çmimin e lidhjes.

30.2. Operatori i rrjetit të distribuicionit mund ta lidhë një konsumator i cili është i vendosur në territorin e një operator tjetër të rrjetit të distribuimit, në qoftë se ai merr leje me shkrim nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe në qoftë se është në interesin e përgjithshëm të konsumatorëve.

30.3. Kushtet për t'u lidhur në rrjetin e distribuimit apo të bartjes rregullohen në rregullat e Kodit të Rrjetës ose Kodin e Distribuimit të publikuar. Ato do të miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji para hyrjes së tyre në fuqi.

## Neni 31

31.1. Konsumatorët ose prodhuesit e përmendur në nenin 25 të këtij ligji nuk kanë të drejtë të lidhen nëse nuk i kanë plotësuar kushtet për lidhje apo nëse lidhja do të shpiente deri te çrregullimi i furnizimit, ose lidhja do të shkaktonte shpenzime jashtëzakonisht të larta ndaj furnizuesit në rrjetë.

31.2. Një ndërmarrje e energjisë elektrike mund ta refuzojë përkohësisht lidhjen e një konsumatori ose prodhuesi në rrjetë nëse konstaton se pajisjet, aparatura e tij, ose kur rrjeta nuk i plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në kodet teknike. Konsumatori ose prodhuesi duhet të informohet me shkrim për arsyet e çdo refuzimi të tillë.

## Neni 32

32.1. Furnizuesit munden që përkohësisht ta suspendojnë furnizimin me energji elektrike në bazë të rrethanave të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe në Kushtet e Përgjithshme për Furnizim.

32.2. Furnizuesit mund ta ndërprejnë furnizimin me energji elektrike për konsumatorët që nuk paguajnë detyrimet, në përputhje me rregullat e nxjera nga Zyra e Rregullatorit për Energji që kanë të bëjnë me personat vunerabël dhe ndërprerjet gjatë sezonit të dimrit.

32.3. Furnizuesit do të ndërprejnë furnizimin me energji elektrike ndaj konsumatorëve me apo pa njoftim paraprak në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

## **Kreu 10 MATJA DHE LLOGARITJA**

### Neni 33

33.1. Energjia elektrike e shfrytëzuar nga klientët matet me pajisje matëse komerciale që duhet të vendoset sa më afër që është e mundur në kufi të pronës së klientit në përputhje me kërkesat e Kodit të Matjes.

33.2. Operatori i rrjetit të bartjes ose distribuimit përcakton tipin, numrin dhe vendin e montimit (instalimit) për pajisjen matëse komerciale si dhe kontrollin gjegjës dhe mënyrat e komunikimit.

33.3. Operatori i rrjetit të bartjes ose distribuimit e instalon pajisjen matëse komerciale. Në rast se tarifat e miratuara ua mundësojnë një grupi të konsumatorëve të zgjedhin llojin dhe tipin e pajisjes matëse, ndërmarrja e bartjes ose distribuimit duhet ta instalojë pajisjen matëse komerciale e cila korrespondon me zgjedhjen e klientëve që duhet të theksohet me shkrim.



## Neni 34

34.1. Pajisjet matëse komerciale për matjen e energjisë elektrike janë pronë dhe i takojnë rrjetit të bartjes ose distribuimit.

34.2. Me kërkesë të konsumatorit dhe në llogari të tij mund të instalohet pajisja shtesë për matjen dhe shpenzimin e energjisë elektrike nga konsumatori.

34.3. Në rast të çfarëdo dallimi në matje ndërmjet matësve sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni përtej nivelit të pranueshëm të saktësisë, konsumatori ka të drejtë të kërkojë një ekspert të caktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për ta vërtetuar saktësinë e matjes.

## Neni 35

35.1. Konsumatorët duhet t'i paguajnë faturat për shpenzimin e energjisë elektrike dhe u ipet zgjedhje e gjerë (mundësi e gjerë për zgjedhje) për mënyrën e pagesës për përmbushjen e faturave të tyre.

35.2. Kushtet dhe procedura për faturim, faturat e pagesave dhe pagesat definojnë në Kushtet e Përgjithshme për Furnizim dhe Pranim të Energjisë Elektrike të nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

## **Kreu 11 BARTJA NDËRKUFITARE E ENERGJISË ELEKTRIKE**

## Neni 36

36.1. Eksporti dhe importi i energjisë elektrike bëhet nga ndërmarrjet e energjisë elektrike të cilat kanë liçencë për aktivitete të këtilla.

36.2. Poseduesi i liçencës për eksport ose import të energjisë elektrike duhet ta informojë Zyrën e Rregullatorit për Energji për çdo kontratë të lidhur mbi furnizimet ndërkufitare me energji elektrike. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të ndalojë zbatimin e kontratës për furnizim me energji elektrike brenda dy javësh pas pranimi të njohtimit të kontratës.

36.3. Në rast se Zyra e Rregullatorit për Energji nuk mund t'i përgjigjet brenda afatit të specifikuar në paragrafin (2) të këtij neni, Zyra e Rregullatorit për Energji mund të pezullojë zbatimin e kësaj kontrate për një afat jo më të gjatë se 4 javë.

36.4. Me përjashtim të kushtëzimeve në paragrafet 1 deri në 3, një prodhues mund të eksportojë energjinë elektrike dhe konsumatorët e privilegjuar mund të importojnë energji elektrike për nevojat e tyre.

36.5. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të ndalojë zbatimin e kontratave për furnizimin ndër-kufitar me energji elektrike nëse është shkelur parimi e reciprocitetit ose në qoftë se është kërcënuar stabiliteti i sistemit të energjisë elektrike.

## Neni 37

37.1. Tranziti i energjisë elektrike mund të kryhet nga një ndërmarrje e energjisë elektrike e cila ka liçencë për këtë aktivitet.

37.2. Kur kërkohet me një marrëveshje ndërkombëtare ose me një traktat ndërshtetëror të lidhur me Kosovën, i liçencuari për aktivitetet e energjisë elektrike bënë tranzitin e energjisë elektrike përmes rrjetës të bartjes në bazë kushteve dhe në mënyrën e paraparë me marrëveshje ose me një marrëveshje sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit.

## **Kreu 12 DISPOZITAT KALIMTARE**

## Neni 38

38.1. Brenda një viti nga data e shpalljes së këtij ligji, operatorët e sitemit për bartje dhe distribuim, do të instalojnë aparatet matëse për çdo konsumatorë që është i kyçur në sistemin e tyre dhe i cili nuk posedon pajisjen matëse që nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

38.2. Obligimi i operatorëve të sitemit, për të blerë pajisje matëse nga konsumatorët, sipas paragrafit 38.1, nuk do të vlejë në rast se operatori i sitemit instalon pajisjen e vet për të zëvendësuar pajisjen ekzistuese, sipas kushteve për instalimin e pajisjeve matëse.

38.3. Relacionet komerciale përcaktohen në sektorin e energjisë elektrike në përputhje me kërkesat e këtij ligji që nuk do të jetë më vonë se 18 muaj nga data e shpalljes të këtij ligji.

38.4. Furnizuesi publik duhet të përgatitë dhe t'i propozojë secilit klient kontratën për furnizim me energji elektrike sipas kushteve të precizuara në paragrafin 38.3 të këtij neni.

38.5. Në rast të çdo dështimi të lidhjes së kontratës komerciale për furnizim me energji elektrike brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 38.3 të këtij neni, operatorët e rrjetit mund ta shkyqin personin që merr apo furnizohet në mënyrë të paligjshme me energji elektrike nga ndërmarrja për furnizim me energji elektrike.

38.6. KEK-u do të bëjë kërkesën për liçencë për aktivitetet e saja prodhuese dhe të furnizimit publik brenda 90 ditëve që nga shpallja e këtij ligji.

38.7. Operatori i rrjetit të bartjes përgatitë Kodin e Rrjetës, Kodin e Standardeve të Energjisë Elektrike, Kodin për Mbrojtjen e konsumatorëve, Kodin e Pajisjeve Elektrike, Kodin e Matjes, Kodin e Distribuimit dhe t'ia paraqet ato për miratim Zyrës të Rregullatorit për Energji brenda 18 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 39

Ky ligj hyn në fuqi mbas miratimit të tij nga Kuvendi i Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga PSSP-ja.

**Ligji Nr. 2004 / 10  
29 Prill 2004**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës**

---

**akademik Nexhat Daci**